

UNDEF

The United Nations
Democracy Fund



FNUD

Fonds des Nations Unies
pour la démocratie



**Raport mbi realizimin e
premtimeve elektorale të
z. Rakip Suli, Kryetari i
Bashkisë Kamëz**

PROJEKTI

**“Ndjekja dhe verifikimi i
premtimeve të fushatës
zgjedhore në Shqipëri”**

Mbështetur nga:

**Fondi për Demokraci i Kombeve të
Bashkuara**

Për më tepër informacion vizitoni platformën online “Matësi Elektorale” (The Albanian Truth-o-Meter Platform):

www.matesielektor.al

Ju mirëpresim të kontribuoni me ide dhe sugjerime mbi shpenzimet/investimet buxhetore lokale apo të qeverisjes qendrore si dhe mbi premtimet elektorale të realizuara ose të parealizuara të të zgjedhurve lokalë dhe anëtarëve të qeverisë.

E-mail: rdakorca@gmail.com

Tel: + (355) 822 42626

Premtimet elektorale të z. Rakip Suli, Kryetari i Bashkisë Kamëz

1. Vëmendje imediate përgjatë qeverisjes lokale të Bashkisë Kamëz, në këtë zonë, do të drejtohet menjëherë në përmirësimin imediat të infrastrukturës;
2. Ndërtimin e çerdheve dhe kopshteve si një nevojë e madhe për fëmijët;
3. Do punohet dhe në projektimin dhe ndërtimin e hapësirave rekreative, këndeve të lojërave dhe mjediseve çlodhëse;
4. Pastrimi dhe trajtimi i mbetjeve për një jetesë kualitative dhe të shëndetshme.

Burimi: <https://ata.gov.al/2019/06/21/suli-permiresim-te-infrastruktures-ne-babrru-ne-4-vitet-e-ardhshme/>

Premtimet e arritura

1. Përfundoi puna për shtrirjen e rrjetit të kanalizimeve dhe rrjetit nëntokësor, ndërtimin e trotuareve dhe asfaltimin përgjatë aksit rrugor “Muharrem Bajraktari” në Laknas, Nj. Adm. Kamëz.
2. Përfundoi rikonstruksioni i rrugës “Berisha”.
3. Rindërtimi me të gjitha standartet bashkëkohore i kopshtit “Lidhja e Prizrenit” në Paskuqan
4. Përfundoi puna për shtrirjen e rrjetit të kanalizimeve dhe rrjetit nëntokësor, ndërtimin e trotuareve dhe asfaltimin përgjatë rrugës “Pekin”, në Kamëz.
5. Përfundoi puna për shtrirjen e rrjetit të kanalizimeve dhe rrjetit nëntokësor, ndërtimin e trotuareve dhe asfaltimin përgjatë rrugës “Gjergj Fishta”, në Bathore.
6. Përfundoi asfaltimi i rrugës “Klenjë”, në Bathore.
7. Përfundoi asfaltimi i rrugës “Zall-Dardhe” në Bathore.
8. Vendosja e ndriçimit rrugor në rrugën “Brukseli” në Kamëz.
9. Vendosja e ndriçimit rrugor në rrugën “Onufri” në Kamëz.
10. Vendosja e ndriçimit rrugor përgjatë aksit rrugor “Jehona”, në lagjen nr. 1, Valias.
11. Kangjella të reja mbrojtëse përgjatë shkollës 9-vjeçare “Ahmet Zogu”, Bathore.
12. Ndërtimi i KUN në rrugën “Marin Barleti” në Paskuqan.
13. Kënd i dytë lojërash për vogëlushët e bllokut të pallateve në rrugën “Demokracia” në Paskuqan.
14. Përfundoi rehabilitimi i urës tek rruga “Elez Isufi” në Babrru.
15. Rikonstruksioni i rrugës “Lura” në Laknas.
16. Rindërtimi i kopshtit “Niko Hoxha” në fshatin Valias, Nj. Adm. Kamëz.
17. Rikonstruksioni i shkollës dhe kopshtit “Halit Çoka” në fshatin Bathore, Nj. Adm. Kamëz.
18. Rehabilitimi i rrugës, vendosja e ndriçimit dhe shtrirja e rrjetit të kanalizimeve, në rrugën “2 Prilli” në fshatin Bathore, Nj. Adm. Kamëz.
19. Asfaltimi i rrugës “Faik Kulla” dhe “Xhemal Kada” në Fushë Kërçik, Nj. Adm. Paskuqan.
20. Shtrimi i rrjetit të ujësjellësit përgjatë rrugës “Besëlidhja” në Bathore, Nj. Adm. Kamëz.
21. Rikonstruksioni i rrugës “Bujar Bishanaku” në Babrru Qendër, Nj. Adm. Paskuqan.
22. Rikonstruksioni i rrugës “Marin Barleti” me gjatësi 850 m, në Paskuqan.

23. Vendosja e ndriçimit publik në segmentin rrugor Paskuqan 1 – Paskuqan 2 – Babrru – Fushë Kërçik.
24. Rindërtimi i rrugës “Nik Ndreka” në Kodër të Kuqe, Nj. Adm. Paskuqan.
25. Shtrirja e rrjetit ujësjellës në rrugën “Teuta” në Bathore.
26. Asfaltimi i rrugës “Vlora” në fshatin Laknas, Nj. Adm. Kamëz.
27. Ndërtimi i rrjetit të ri ujësjellës në rrugën “Dajti”, në lagjen 5, Bathore.
28. Rehabilitimi i rrugës “Hasan Zylfia” në fshatin Babrru, Nj. Adm. Paskuqan.
29. Ndërtimi i rrjetit të ri ujësjellës në rrugën “Jani Vreto” në Bathore.
30. Ndërtimi i rrjetit të kanalizimeve në zonën e “Qendër Kamzës”.
31. Shtrirja e rrjetit të ri ujësjellës përgjatë rrugës së “Arbrit” në Bathore.
32. Asfaltimi i rrugës “Mit’hat Frashëri” në zonën e Kodrës së Kuqe, Nj. Adm. Paskuqan.
33. Rikonstruksioni i urës që lidh Paskuqanin me Tiranën.
34. Rikonstruksioni i kopshtit “Nënë Tereza” në Kamëz.
35. Vendosja e ndriçimit publik në rrugën “Kongresi i Manastirit” në Kamëz.
36. Sistemimi dhe asfaltimi i rrugës “Argjinatura” në Kamëz.
37. Rrjet i ri ujësjellësi në lagjen 5, Bathore.
38. Riasfaltimi dhe vendosja e trotuareve përgjatë rrugës “Skënderbeu” në fshatin Laknas, Nj. Adm. Kamëz.
39. Ndërtimi i këndit të parë të lojërave për fëmijët e zonës Babrru Qendër.
40. Vendosja e ndriçimit rrugor në rrugët “Kukësi”, “Paqësori” dhe “Rilindja”.
41. Asfaltimi i rrugëve “Gurre” dhe “Gjoric” në Bathore.
42. Asfaltimi i rrugëve “Mark Titra” dhe “Mehdi Frashëri” në Paskuqan.
43. Rifreskimi dhe vendosja e kangjellave mbrojtëse, në të gjithë territorin e Bashkisë Kamëz, me qëllim maksimizimin e sigurisë së qytetarëve.
44. Rehabilitimi i rrugës “Fan Noli” dhe “Faik Konica” në zonën e Paskuqanit.
45. Asfaltimi i rrugës “Jani Vreto” dhe “Johan Shtraus” në Njësinë Administrative Bathore.
46. Sistemimi, pastrimi dhe rrethimi i varrezave, me kangjella mbrojtëse, në Laknas, Nj. Adm. Kamëz.
47. Asfaltimi i rrugës “Ibrahim Rugova” dhe “Mark Tirta” në Paskuqan.
48. Rehabilitimi i kanalizimeve të ujërave të zeza në zonën “Kamza e Re”.
49. Rehabilitimi i rrugëve “Ndoc Deda” dhe “Mustafa Kruja” në zonën Babrru Qendër.
50. Rehabilitimi i banesave ekzistuese për familjet në nevojë, familjet me ndihmë ekonomike, nënat kryefamiljare, familjet rome dhe egjiptiane, në Paskuqan.
51. Asfaltimi i rrugës “Strasburg” në Kamëz.
52. Asfaltimi dhe vendosja e ndriçimit në rrugën “Themistokli Gërmenji” në fshatin Babrru, Nj. Adm. Paskuqan.
53. Asfaltimi i rrugës “Fierza” në Kamëz.

Premtime pjesërisht të arritura (në proces)

1. Vijon puna për rikonstrukcionin total të kopshtit “Jashar Hoxha” në Paskuqan.
2. Vijon rehabilitimi i kanaleve të ujërave të zeza në rrugën “Nazmi Rushiti”, Kamëz.
3. Vazhdojnë punimet për rikonstrukcionin e gjimnazit "Ibrahim Rugova", me të gjitha standartet bashkëkohore.
4. Vijon puna për rikonstrukcionin e shkollës dhe kopshtit “Dom Nikollë Kaçorri”, në Laknas.
5. Vijon puna për shtrirjen e rrjetit të ujësjellësit me gjatësi 30,960 ml në rrugët “Ndre Mjeda” dhe “Ndrek Luca” në Fushë-Kamëz.
6. Vijon puna për ndërtimin e rrugëve “Halil Hoxha”, “Islam Spahia”, “Ded Gjo Luli” dhe “Riza Troci” në Paskuqan 2.
7. Vijon puna për rindërtimin e rrugëve “Hasim Vokshi”, “Ali Pashë Tepelena”, “Prezë” dhe “Sllovë” në Bathore.
8. Vijon puna për ndërtimin e KUN në Valias, investim nga i cili përfitojnë 15700 banorë të Bashkisë Kamëz.
9. Vijon puna për rehabilitimin e digës së liqenit në Paskuqan.
10. Vijon puna për shtrirjen e rrjetit të ujësjellësit në rrugën “Rilindja”, në Valias të Ri.
11. Vijon puna për rikonstrukcionin total të shkollës “Tahir Sinani”, në Paskuqan.
12. Vazhdojnë punimet për ndërtimin e çerdhes në Babrru, për 130 vogëlushë.
13. Vijon puna me ritme të larta për ndërtimin e KUN me gjatësi 900ml në Laknas.
14. Në rrugën “Përjetësia” në Valias, vijon puna për shtrirjen e rrjetit të ujësjellësit. Një investim me gjatësi 83 km, nga i cili përfitojnë 15.700 banorë të Bashkisë Kamëz.
15. Në rrugën “Harku i Triumfit” në Valias, vijon puna për ndërtimin e KUN prej 22.5 km. Një investim prej të cilit përfitojnë 15700 banorë të zonës, duke zgjidhur problemin e përmbytjeve.
16. Viojnë punimet për shtrirjen e rrjetit ujësjellës përgjatë rrugës “Albanët” në Valias të Ri dhe Kamëz e Re.
17. Vazhdojnë punimet për shtrimin e trotuareve, ndriçimin dhe ndërtimin e 160 ml aks rrugor në rrugën “Bërxullë”, Bathore.
18. Në rrugën “Farkë”, në Bathore, vazhdon puna për ndërtimin e 400 ml aks rrugor si dhe për rehabilitimin e KUN.
19. Në Bathore vijon puna për ndërtimin e rrugës “Grykë Çaje”, me një gjatësi prej 140 ml si dhe për ndërtimin e trotuareve.
20. Vijon puna për ndërtimin e rrugës “Muharrem Bajraktari” në Laknas.
21. Vazhdon puna për ndërtimin e KUN-ve në rrugën “Idriz Seferi”, 330 m në Bathore; “Shebeniku”, 240 m, Laknas; “Buna”, 350 m, Laknas dhe pranë shkollës “Ibrahim Basha”, 60 m, Bulçesh.
22. Vijon puna për ndërtimin e rrugës “Thethi” në Valias.
23. Vijon puna për shtrirjen e rrjetit të kanalizimeve, shtrirjen e trotuareve, asfaltimin, vijëzimin dhe ndriçimin në rrugën “Havzi Nela” në Paskuqan.
24. Rruga “Fahri Ramdani” në Paskuqan po transformohet dita ditës me punimet e vazhdueshme për rindërtimin e saj.